

VENDIM
Nr. 514, datë 30.6.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT NR. II NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT, DHE
DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT (GIZ)
GMBH, SI PËRFAQËSUESE E QEVERISË GJERMANE DHE AGJENCI
ZBATUESE, PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR NEGOCIATAT PËR
ANËTARËSIM TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN NË SEKTORIN
EKONOMIK” (SANECA II)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. II, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në sektorin ekonomik” (SANECA II), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

NFE 11447/1
DT 4.7.2023

ndërmjet

MARRËVESHJE ZBATIMI Nr.II

**Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**

Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5

65760 Eschborn

- në vijim i referuar si "GIZ" -

dhe

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

- në vijim i referuar si "pala zbatuese" -

në lidhje me projektin

**"Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë
në BE në sektorin ekonomik" (SANECA II)**

- në vijim e quajtur si "Projekti" -

MARRËVESHJE ZBATIMI PËR PROJEKTET E BASHKËPUNIMIT TEKNIK

Përmbajtja

Baza e Marrëveshjes

1. Objektivi dhe treguesit e Projektit

2. Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

2.1 Sigurimi i ekspertëve

2.2 Kostot operacionale dhe administrative

2.3 Kontribute të tjera

3. Kontributet e MFE-së

3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

3.2 Kostot

3.3 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

4. Dispozita të tjera

4.1 Vlerësimi

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe mbarimi i Marrëveshjes

4.3 Afati i Marrëveshjes

4.4 Modifikimi i Marrëveshjes

4.5 Forma me shkrim

4.6 Marrëveshjet me organizatat zbatuese individuale

4.7 Marrëveshja e Zbatimit

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

4.9 Hyrja në fuqi, kopjet

Shtojcat

Baza e Marrëveshjes

1) Parashikimet e mëposhtme do të formojnë bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik e datës 21 tetor 1988 (Shtojca 1).
- Ligji nr.65 datë 03/10/2019 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)" (Shtojca 2).
- Procesverbali i Negociatave për Zhvillim e Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtur virtualisht më 24 nëntor 2020 (Shtojca 3). Në këtë procesverbal parashikohet që Qeveria Gjermane do të sigurojë vazhdimin e angazhimit për projektin vijues SANECA II (Shtojca 3)
- Procesverbali i Negociatave për Zhvillim e Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë i mbajtur më 13.12.2022 (Shtojca 3.1). Në këtë procesverbal parashikohet që Qeveria Gjermane do të sigurojë financimin e projektit vijues SANECA II me një fond shtesë mbi atë të rënë dakord në procesverbalin e negociatave të datës 24 nëntor 2020.
- Nota Verbale VN-Nr.: 181/2022, datë 31/08/2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për shtimin e fondeve të projektit vijues SANECA II (Shtojca 4), duke bërë referimin në Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik" (SANECA), datë 25 qershor 2019 (shih Shtojcën 2). Në këtë marrëveshje parashikohet se ajo është e aplikueshme për masa të tjera vijuese nga Qeveria Gjermane.
- Autorizimi, nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, dhënë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i datës 12.01.2023 (Shtojca 5)
- Shtojca 6 jep një përmbledhje të alokimeve buxhetore për projektin SANECA II.

2) Në përputhje me nenin 2 të Marrëveshjes së sipërpërmendur të ratifikuar me ligjin nr. 65/2019, detajet e projektit duhet të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet GIZ-s dhe MFE-së. GIZ-ja vepron në zbatim të autorizimit, i cili i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3) Kjo Marrëveshje mbulon fazën e zbatimit nga 2023 deri më 31/01/2026.

1. Objektivi dhe treguesit e Projektit

Objektivi i këtij Projekti është:

Administrata shqiptare është e aftë të zhvillojë bisedimet e anëtarësimit në BE në grupkapitujt e tregut të brendshëm, me pjesëmarrjen e palëve të interesit.

GIZ dhe MFE janë të angazhuar bashkërisht për këtë objektiv.

Treguesit për arritjen e këtij objektivi janë:

- (1) Raporti vjetor i Komisionit të BE-së vëren një nivel më të mirë përgatitjeje ose progres vjetor në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në 8 nga 10 kapitujt e mbështetur të grupkapitujve (*cluster*) të tregut të brendshëm (+ kapitullin 20).
- (2) Për 50% të akteve ligjore për të cilat projekti ka ofruar këshillim për administratën shqiptare në fushën e grupkapitujve (*cluster*) të tregut të brendshëm, janë në dispozicion vlerësimet përkatëse të ndikimit rregullator çka dokumenton se aktet ligjore janë shqyrtuar lidhur me rëndësinë që kanë për barazinë gjinore.
- (3) 50% e përafërsisht 120 anëtarëve joshtetërorë të Tryezave të Konsultimit të Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian, në mesatare e vlerësuan procesin e trajtimit të rekomandimeve dhe pozicioneve të aktorëve joshtetërorë në Platformë si të mirë ose si shumë të mirë.

Fushat e ndërhyrjes (Rezultatet) përfshijnë:

1) **Rezultati 1** synon të sigurojë që anëtarët e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE-të) të jenë të pajisur me instrumentet e nevojshme të punës dhe të këshillohen për përgatitjen e 10 paketave të prezantimeve për takimet dypalëshe, në mënyrë që procesi i shqyrtimit analitik, si një moment i rëndësishëm në bisedimet e pranimit në BE, të finalizohet me cilësinë e duhur.

2) **Rezultati 2** synon të sigurojë harmonizim të mëtijshëm me *acquis* e BE-së në fusha të përzgjedhura që janë me prioritet të lartë dhe të planifikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, duke garantuar përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit rregullator (RIA) dhe marrjen në konsideratë të aspekteve të barazisë gjinore. Kjo do të kontribuojë në rritjen e nivelit të përafrimit duke e vendosur qeverinë shqiptare në një pozicion më të mirë negociues në bisedimet e anëtarësimit dhe duke siguruar një kuadër rregullator më të mirë në fushat në fjalë, i cili reflekton standardet e BE-së.

3) **Rezultati 3** synon të përmirësojë dialogun midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në lidhje me procesin e negociatave dhe të promovojë një kulturë besimi dhe bashkëpunimi të ndërsjellë, duke siguruar që ata të jenë të informuar siç duhet, si edhe të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të konsultohen për çështjet që i prekin. Kjo do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore ndaj palëve të interesuara gjatë procesit të negociatave.

Ndryshimi i objektivit ose fushave të ndërhyrjes është gjithmonë subjekt miratimi nga Qeveria Gjermane.

Treguesit e Projektit janë përcaktuar në autorizimin e BMZ-së. Çdo ndryshim, teknik apo financiar, do të zyrtarizohet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet palëve.

Projekti do të zbatohet së bashku me MFE-në si partneri kryesor i Projektit. Në varësi të aktiviteteve në përputhje me objektivin e Projektit, SANECA II mund të përfshijë institucione të tjera si partnerë të drejtpërdrejtë të Projektit.

GIZ dhe MFE do të krijojnë dhe mbajnë strukturën drejtuese dhe zbatuese të mëposhtme për kohëzgjatjen e Projektit:

Emri	Përfaqësimi	Roli	Shpeshtësia
Komiteti i Drejtimit Politik (KDP)	Ministri/ja dhe Zëvendësministri/ja e Financave dhe Ekonomisë, Kryenegociatori/ja; Përfaqësues nga Ambasada Gjermane; Drejtuesi/ja e GIZ për Shqipërinë; Drejtuesja e Projektit SANECA II;	Vendimmarrje në rast të ndryshimeve madhore që kërkojnë gjatë zbatimit të projektit. Shkeljet themelore të vlerave të përbashkëta trajtohen në këtë nivel.	Mblidhet <u>vetëm nëse</u> ndodh ndonjë ndryshim madhor në zbatimin e projektit
Komiteti i Drejtimit Strategjik (KDS)	Zëvendësministri/ja e MFE, Negociatorët/et e kapitujve në fokus, Përfaqësues të zyrës së Kryenegociatorit/es, Drejtuesi/ja e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Përfaqësues nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, Përfaqësues nga Ambasada Gjermane, Drejtuesi/ja e GIZ për Shqipërinë, Drejtuesja e Projektit SANECA II, Të tjerë sipas nevojave.	Drejtimi strategjik, miratimi i planit operacional vjetor, monitorimi i performancës	Njëherë në vit dhe sipas nevojës
Grupi(et) i Drejtimit Operacional (GDO)	Personat teknikë të kontaktit për çdo kapitull, Anëtarët e sekretariatit teknik për kapitujt në fokus, Përfaqësues nga departamentet e Integritetit të MFE-së dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse për kapitujt në fokus, Menaxherët/et e trajnimit në ASPA, Stafi i projektit SANECA II, etj.	Planifikimi i detajuar dhe zbatimi i aktiviteteve sipas planit operacional të miratuar	Çdo tremujor (ose më shpesh nëse gjykohet e nevojshme)

Komunikimi dhe raportimi:

Të dyja palët angazhohen të mbajnë njëra-tjetrën të informuar dhe të përditësuar me zhvillimet më të fundit të aktiviteteve të Projektit, si dhe me informacione të tjera, materiale, dokumente dhe raporte që ndikojnë ose janë të dobishme për zbatimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të projektit.

2. Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-së.

Në përputhje me autorizimin nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, dhënë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i jepet GIZ-së një shumë prej 3'000'000 EURO (tre milion euro) për kontributin Gjerman. Kjo shumë duhet të përfshijë kostot e Organizatës Zbatuese Gjermane.

Kohëzgjatja e përgjithshme e projektit është planifikuar deri në 31/01/2026. Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej 6 (gjashtë) muajsh, deri më 31/07/2026, për të siguruar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumenteve të projektit tek pala tjetër.

2.1 Sigurimi i ekspertëve

GIZ-ja do të bëjë të disponueshme për projektin

- një ekspert kombëtar afatgjatë për Integrimin European, që në të njëjtën kohë do të jetë drejtues i grupit të ekspertëve të disponueshëm për këtë Projekt për kohëzgjatjen e fazës aktuale të tij;
- katër ekspertë kombëtarë afatgjatë që do të jenë përgjegjës për të koordinuar dhe për të dhënë ekspertizën teknike lidhur me aktivitetet e projektit, komunikimin me institucionet partnere, menaxhimin financiar dhe të njohurive, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të projektit;
- një menaxher për financat dhe zyrën
- një punonjës mbështetës (part time)
- deri në 2400 ditë pune për ekspertët ndërkombëtarë dhe deri në 3950 ditë pune për ekspertët kombëtarë afatshkurtër për fushat specifike dhe për aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve, sic do përcaktohet në planin e aktiviteteve.

2.2 Kostot operacionale dhe administrative

GIZ-ja do të përballojë kostot operacionale dhe/ose administrative të lidhura me administrimin e kontributit Gjerman për Projektin.

2.3 Kontribute të tjera

GIZ-ja do të japë kontributet e tjera të mëposhtme:

- do të mbulojë financimin e shërbimeve të përkthimit dhe redaktimit për materiale dhe takime përkatëse që lidhen me zbatimin e aktiviteteve të projektit.
- do të mbulojë financimin e publikimeve të ndryshme sipas planit të aktiviteteve.

3. Kontributet e MFE

MFE cakton personat e kontaktit brenda Ministrisë për t'i siguruar mbështetje Projektit për nevojat ditore në zbatimin e aktiviteteve, përgjatë gjithë fazës së zbatimit.

3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

MFE:

- do të sigurojë personel të kualifikuar për të planifikuar dhe zbatuar bashkërisht aktivitetet e vecanta të parashikuara në planin e aktiviteteve;
- do të këshillojë në mënyrë strategjike mbi procesin e zbatimit të Projektit dhe ndryshimet organizative në zbatim të prioriteteve dhe strategjive të qeverisë shqiptare, në koordinim edhe me burime të jashtme të asistencës teknike dhe financiare;
- do të marrë pjesë në Strukturat Drejtuese të Projektit;
- do të sigurojë përfaqësimin e duhur nga MFE dhe agjencitë përkatëse zbatuese, në strukturat drejtuese të Projektit. Të organizojë dhe zhvillojë mbledhjen e Komitetit të Drejtimit Strategjik (KDS) të paktën një herë në vit, duke përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e Procesverbalit të Mbledhjes për të gjithë pjesëmarrësit;
- do të sigurojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e institucioneve të tjera shqiptare gjatë zbatimit të Projektit;
- do të sigurojë informacion dhe komunikim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me Projektin lidhur me të gjitha çështjet e aktiviteteve të tij.
- do të sigurojë pjesëmarrjen e stafit të MFE dhe institucioneve të tjera të linjës, në masat e zhvillimit të kapaciteteve.

3.2 Kostot

MFE do të mbulojë kostot e aktiviteteve të përbashkëta (publikime, seminare, turne studimi, etj) vetëm nëqoftëse ato e tejkalojnë kontributin e GIZ-së, sipas planit të aktiviteteve të rënë dakort. MFE do të garantojë se kostot që do të specifikohen në planin e aktiviteteve do të buxhetohen në kohën e duhur.

3.3 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

MFE:

- mbart TVSH për kostot e aktiviteteve të projektit dhe shpenzimet përkatëse të kryera në Shqipëri (shpenzime operative dhe prokurime) si edhe për prokurimet/importet ndërkombëtare në një shumë përafërsisht 35.000,00 EUR (rreth 4.000.000,00 ALL) dhe siguron buxhetim të mjaftueshëm në kohën e duhur.
- Rimbursimi i TVSH-së ndaj GIZ-së është i vlefshëm për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, me përjashtim të prokurimeve/importeve ndërkombëtare, të cilat nuk i nënshtrohen rimbursimit të TVSH por vetëm përjashtimit prej saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për TVSH.

4. Dispozita të tjera

GIZ-ja (Drejtuesi i Projektit) dhe MFE (Personi përgjegjës për Projektin) do të takohen në intervale të rregullta kohe për të monitoruar zbatimin dhe për të rënë dakort mbi ndonjë ndryshim që mund të jetë i nevojshëm.

GIZ-ja dhe MFE do të informojnë njëra-tjetrën mbi çdo zhvillim të ri që mund të influencojë Projektin.

4.1 Vlerësimi

GIZ-ja dhe MFE bien dakort për monitorimin dhe vlerësimin e përbashkët të Projektit. GIZ-ja mund të ndërmarrë një vlerësim për Projektin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Për këtë qëllim, GIZ-ja do të delegojë ekspertë/vlerësues për Projektin. MFE do të marrë pjesë në vlerësim. Ajo në të gjitha rastet do të ndihmojë ekspertin(ët)/vlerësuesin(t) në punën e tyre dhe do t'i lejojë ata të ekzaminojnë të gjitha dokumentet e nevojshme.

MFE do të informohet në lidhje me rezultatet e vlerësimit me anë të një raporti.

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe mbarimi i Marrëveshjes

GIZ-ja mund të pezullojë kontributin e saj nëse:

- MFE nuk përmbush detyrimet që dalin nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje, ose
- linden rrethana që e përjashtojnë, ose vendosin në rrezik, objektivin e Projektit të përshkruar në Klauzolën 1 më lart.

Nëse lind një prej rrethanave të përshkruara në fjalinë 1 më lart dhe është akoma në ekzistencë mbas një afati të rënë dakord nga GIZ dhe MFE, ose nëse nuk është eliminuar brenda kësaj periudhe, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, GIZ mund ta mbarojë parakohe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Afati i Marrëveshjes

Përveçse kur përcaktohet në Klauzolën 4.2 më lart për pezullimin e kontributeve dhe mbarimin e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për kohëzgjatjen e Projektit (aktualisht i planifikuar të vazhdojë nga 2023 deri në 01/2026). Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej gjashtë muajsh, deri më 31/07/2026 për të mundësuar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumentacionit të përshtatshëm tek pala tjetër.

Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të vonesës në ekzekutimin e kontributit Gjerman siç parashikohet në këtë Marrëveshje dhe në ekzekutimin e kontributeve të rena dakord të MFE.

4.4 Modifikimi i Marrëveshjes

Në rast se klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndihmojnë në arritjen efiçente të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më lart, atëherë GIZ dhe MFE mund t'i ndryshojnë ose amendojnë këto klauzola me pëlqim reciprok në çdo fazë gjatë zbatimit të Projektit. Çdo ndryshim do të bëhet me shkrim.

GIZ mund ta mbarojë në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje nëse tërhiqet autorizimi që i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

4.5 Forma me shkrim

Amendamentet dhe shtesat në këtë Marrëveshje, dhe çdo deklaratë tjetër e rëndësishme dhe komunikim domethënës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duhet të bëhen me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ, do të mjaftonte që ato të merreshin nga udhëheqësi i grupit të ekspertëve të siguruar.

4.6 Marrëveshjet me organizatat zbatuese individuale

Personi përgjegjës për kontributin e GIZ dhe personi(at) përgjegjës për kontributet nga organizatat partnere ose organizatat e tjera zbatuese mund të lidhin së bashku marrëveshje të detyrueshme për detajet shtesë në lidhje me zbatimin e Projektit (p.sh. në bazë të një plani veprimesh), ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtashme t'i përcaktojnë këto detaje me shkrim dhe, sipas rastit, të ndryshojnë atë marrëveshje që të marrë në konsideratë ndryshimet në Projekt.

4.7 Marrëveshja e Zbatimit

Për parashikimet që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, referimi bëhet në parashikimet e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik e datës 21 tetor 1988 (Shtojca 1) dhe në ligjin nr. 65/2019 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projekin "Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik" (Shtojca 2).

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve, ato do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur nëpërmjet negociimeve. Nëse kjo nuk arrihet, komunikimet do të ndiqen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

4.9 Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të palës shqiptare për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore. Kopjet në të cilat shtypet marrëveshja, janë po aq sa palët në marrëveshje. Ajo do të hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe dy kopje origjinale në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e tekstit, gjuha angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, 04.07.2023

Për Deutsche Gesellschaft für
(GIZ) GmbH


Dr. Sonja Kurz
Drejtor i GIZ-it për Shqipërinë

Tiranë, 04.7.23

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë


Znj. Delina Ibrahimaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Shtojcat

Shtojca 1:

Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, e datës 21 tetor 1988.

Shtojca 2:

Ligji nr. 65 datë 03/10/2019 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik (SANECA)”

Shtojca 3:

Procesverbali Përmbledhës i Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mbajtur në Tiranë më 24 nëntor 2020

Shtojca 3.1:

Procesverbali i Negociatave për Zhvillim e Bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë i mbajtur më 13.12.2022

Shtojca 4:

Nota Verbale VN-Nr.: 181/2022, datë 31/08/2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për shtimin e fondeve të projektit vijues SANECA II

Shtojca 5:

Autorizimi, nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, dhënë Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i datës 12.01.2023

Shtojca 6:

Përmbledhje e alokimeve buxhetore për SANECA II

Marrëveshje Qeveritare (Notë verbale)	Akt ligjor	Marrëveshje e zbatimit ndërmjet palëve	Buxheti
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin	Ligji nr. 65/2019 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Mbështetje për negociatat për	Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga MFE dhe GIZ në lidhje	2.000.000 Euro ¹ (dy milionë Euro)

¹ Seksionin 2, Kontributet për Projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-së.

Teknik, datë 21 tetor 1988. Rezultatet e Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 22 Nëntor 2018.	<i>anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik</i> Miraturar nga Parlamenti Shqiptar në datën 03.10.2019.	me projektin <i>"Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik"</i> (SANECA I)	
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, datë 21 tetor 1988. Neni 1 pika 2 është bazë për marrëveshjen e zbatimit. Rezultatet e Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim mbi Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë më 24 nëntor 2020	Akti i miratimit të Projektmarëveshjes së Zbatimit nr.II për SANECA II	Projekt-Marrëveshje Zbatimi nr.II ndërmjet GIZ dhe MFE, në lidhje me projektin <i>"Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik"</i> (SANECA II)	3.000.000 Euro² (tre milionë Euro)

² Seksioni 2, Kontributet nga GIZ/Projekt-marreveshja e zbatimit ndërmjet GIZ dhe MFE, në lidhje me projektin SANECA II, varianti i dt.10.10.2022.

**Nota Verbale VN-Nr.:
181/2022, datë
31/08/2022 e
Ambasadës së
Republikës Federale
të Gjermanisë për
shtimin e fondeve të
projektit vijues
SANECA II**

--	--	--